



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 03-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.03.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë (3) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.03.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marim pjesë të 14 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Vjollca Qestaj-DBF, znj.Gentiana Tofaj-DZHE, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Demokrat Ganijaj-DSHPMSI

Anëtarët prezent

1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK
2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK
3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK
4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK
5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK
6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK
7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK
8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK
9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK
10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK
11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK
12. Festina Maloku - Anëtare, AAK
13. **Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV (Mungon)**
14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV
15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve,
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023,
4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektim rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimëror, ndriçimit publik dhe shërbimet të mbeturinave të Amvisërisë në Komunën e Junikut,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P-73105038-00491-4 zona kadastrale e Junikut të shpallen zona me interes të përgjithshëm publik,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: p-73105038-00069-0 zona kadastrale e Junikut të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publike,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Menagjimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,
8. Kërkesë nga DSHPMSI për plotësim – ndryshim të një pike në Rregullore,
9. Të ndryshme.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, sa i përket kërkesës së drejtorisë për shërbime publike, është kërkesë e imja që të diskutojmë rreth asaj pike por jo të merret vendim, për tjerat pika të rendit të ditës pajtohemi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim nën e ditës me këto pika të lartpërmendura, kush është për? Për 14 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar, kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali u miratua.

2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike e bëri znj.Vjollca Qestaj drejtoreshë për Buxhet dhe Financa, e cila fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoj këtë pike para antarve të kuvendit.

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për të gjithë, sa i përket këtij planifikimi shihet se është një planifikim i dobët, jo i mirë menduar dhe dyshoj se nuk keni ditur ta planifikoni as regjistrimin e

automjeteve, keni planifikuar per regjistrim te automjeteve Shumën ne 6000€, ndërsa realizimi për këtë kategori ka qene 7668€, te hyrat nga shërbimet kadastrale janë të përafërta ndërsa te hyrat nga urbanizmi janë planifikuar 90100 a janë inkasuar vetëm 12€.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje për te gjithë, ta kemi te qarte se ky planifikim ka te beje me vitin 2021-2022, andaj buxheti i vitit 2022 është miratuar ne shtatorin e viti 2021 ku na nuk ishim ne pushtet por ishte planifikim i qeveris paraprake, por përkundër te kësaj nuk dua te lëshohem me fellë por tani meqë kemi rritje te hyrave është mundësia qe nëpërmes kuvendit këto mjete te barten neper kategori te veçanta.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim këtë pikë te rendit te ditës, kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kjo pikë e rendit te ditës u miratua.

3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoreshë ne DBF.

z.Leonard Lolluni, kryetari i Komunës u ankojke se qeveria paraprake e ka lenë ne borje te mëdha a këtu po shohim se nuk ka ditur ti shpenzoj 195000€ ne vitin 2022 mjete këto qe ne tani po duhet ti bartim për vitin 2023, a ne total kanë qenë 270000€ qe bie se afër 100000€ nuk kthehen humbin sepse kanë qenë grande qeveritare qe kryetari komunës nuk ka ditur ti shpenzoj, por përkundër kësaj po dua një sqarim për projektin asfaltimi i rrugës lokale Junik-Jasiq, për cilën rrugë bëhet fjalë këtu si dhe kanalizimi i ujërave te zeza lokacioni “Moronicë” për cilin projekt saktë ne “Moronicë” behet fjalë.

znj.Vjollca Qestaj, këto mjete janë mbledhur nga shtatori i vitit 2022 dhe janë te hyra vetanake qe nuk janë te planifikuara për shpenzime dhe nuk ishin te alokuara, nuk është ky 195000€ ne totale qe ne nuk kemi ditur ta shpenzojmë.

z.Ruzhdi Shehu, janë mjete te pa planifikuara qe janë realizuar ne fund te viti 2022 dhe nuk kanë mundur te shpenzohen, ndërsa pjesa tjetër e projekteve qe kanë mbetur, janë projekte te inicuar te kontraktuar por mjete e tyre kanë mbetur te pa shpenzuara, por ky është procesi i planifikimit dhe i shpenzimit te parasë publike, mos te lëshohem ne ata vetëm sa te bëjmë tema sepse ky është interes përgjithshëm.

z.Zenun Shala, përshëndetje për te gjithë ,sa i përket projektin te kanalizimit te ujërave te zeza, ne bazë te kërkesave te banoreve te lagjes “Moronicë” dhe te lagjes “Qok” jemi ardhur ne përfundim qe mjetet ne shumë prej 55000 qe ta projektojmë projektin për kanalizim te ujërave te zeza për lagjen “Moronicë” dhe lagjen “Qok”.

z.Ruzhdi Shehu, sa i përket projektit të rrugës Junik-Jasiq, ka të bëjë me punë shtesë që kanë dalur po nga ky projekt e që është projekt që ne e kemi trashëguar, ka të bëjë me rrugën që fillon nga rampa në drejtim të fshatit Jasiq.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e qes ne votim këtë pikë të renit të ditës, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota, dhe abstenim 1 votë, konstatoi se kjo pikë e rendit të ditës u miratua.

4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektim rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimëror, ndriçimit publik dhe shërbimet të mbeturinave të Amvisërisë në Komunën e Junikut,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike e bëri z.Demokrat Ganiqaj, Drejtori në DSHPMISI, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë, me pas e sqaroi dhe informoi rreth kësaj pike anëtarët e kuvendit.

z.Leonard Llojuni, desha të ndërlidhem të menagjimi i mbeturinave, kompanija “Ambienti” menagjon vetëm me mbeturinat e amvisnisë dhe të biznesit, por me hapësira publike kush merret?

z.Demokrat Ganiqaj, për këto mbeturina nuk kemi kontraktues.

z.Leonard Llojuni, shqetësuese edhe po ashtu në rrugën Junik-Voksh të shkoza aty mbeturinat janë duke u vazhduar të hedhen edhe nga fshatrat për rreth, nuk hedhen vetëm mbeturinat inerte por të gjitha mbeturinat.

z.Ruzhdi Shehu, pajtona me këtë konstatim, në fund nuk jemi të kënaqur, deponitë e mbeturinave jo formale janë zvogëluar në maksimum, por në si ekzekutiv e kemi detyrim që të raportojmë në kuvend mbi gjendjen e menagjimit të mbeturinave në komune të Junikut, ndërsa sa i përket mbeturinave inerte nuk kemi deponi fund, deponia që ka qene ka qenë jo legale, por jemi duke shikuar që të gjejmë lokacion për këto mbeturina inerte , kemi lidhur marrëveshje me kompaninë “Joos-Krasniqi” që mbeturinat inerte të barten në këtë kompani sepse kjo kompani është e licencuar për trajtimin e mbeturinave inerte, por përkundër kësaj prapa edhe unë nuk jam i kënaqur me këtë gjendje sepse janë duke hedhur mbeturina edhe nga fshatrat për rreth, por besoj se shumë shpejtë do të marim masa që ta pastrojmë atë lokacion dhe do të marim masa që me mos të hedhen mbeturina aty.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për të gjithë, desha të dalë të ndriçimi publik, a është në të Komunën e Junikut që një shtyllë të këtë ndriçim e një jo apo kjo vën vetëm për lagjen Agim Ramadani.

z.Demokrat Ganiqaj, në vitin e kaluar kemi patur rekomandim nga qeveria e Kosovës të mos këtë ndriçim publik për arsyeje të krizës energjetike, por ne kemi marrë iniciativë që të vendosim disa

rregullore qe e bëjnë kufizimin e kohës së ndezjes qe edhe sot është aktive nga ora 18:00-24:00, dhe kjo ka qenë edhe rekomandim nga qeveria qe neper lagje dhe vendbanime te reduktohen shtyllat ndriçuese, një me ndriçim, një pa ndriçim.

z.Sadri Krasniqi, edhe unë desha te ndërlidhem te tema e ndriçimit, e vërteta qëndron se ndriçimi ka qenë shumë i mirë, nuk kemi çka te ankohe mi për këtë por atë çka unë pata, ka te beje me shtrirjen e ndriçimit, ka te beje edhe me kërkesa te qytetarëve e qe është rruga nga “restaurant” ODA deri te restaurant Te Toni si dhe ne lagjen “Krasniq” nga qendra e kësaj lagje ne drejtim te varrezave.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne piken tjetër me radhe.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P73105038-00491-4 zona kadastrale e Junikut të shpallen zona me interes të përgjithshëm publik,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike para anëtarëve te kuvendit e beri z. Zenun Shala drejtor ne DUKM,

z.Sadri Krasniqi, ne si grupi I LDK_se do ta përkrahim këtë iniciativë, por desha me dite këtë vleren e pergjishme prej 20% a e keni paraparë sa është kjo vlerë, a është e lart apo jo.

z.Zenun Shala, këtë e përcakton ministria e financave dhe komisioni qe ta vlerëson atë prone, për momentin ne nuk e dimë.

z.Leonard Lloluni, ne çdo vendim qe është ne interes e qytetarëve te komunës se Junikut ne e perkrasim, por pata një pyetje shtese, ju thate se këtë prone e parashini ta shfrytëzoni si industri te lete te ushqimit, ne çfarë forme planifikoni ta shfrytëzoni këtë pronë si komune, çfarë statusi ka me pase kjo prone ne te ardhmen, a do te ipet ne shfrytëzim.

z.Zenun Shala, këto prona do te jene prona komunale dhe ne shfrytëzim do te epen vetëm ato prona qe parshihen me plan zhvillimore komunal.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim këtë pike, kush është për, për 14 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se pika e 5 e rendit te ditës u miratua.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numer: p-73105038-00069-0 zona kadastrale e Junikut të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publike,

Sqarimin dhe arsyetimin e kesaj pike para anëtarëve te kuvendit e beri z.Zenun Shala, drejtor i DUKM.

z.Leonard Lolluni,edhe për këtë prone e kam të njëjtën pyetje si për pronat që u folën me herët, pra si planifikon komuna ta shfrytëzojë këtë pronë në të ardhmen, a do ta jap në shfrytëzim apo si. Si vendim në do ta përkrahim.

z.Zenun Shala, në atë pjesë në si komune e kemi parapare Qendër Rekracioni të Turizmit, për momentin mund të shfrytëzohet vetëm si rekreacion turistik, për të ndërruar destinimin duhet të pritet 4 vite.

z.Leonard Lolluni, une kisha thënë që të mos i ndërrohet destinacioni.

z.Ruzhdi Shehu, nuk është qëllimi të ndërrohet destinacioni, por as të ndërtimit, është një projekt i zhvillimit ekonomik dhe po shikohet mundësia që të paraqitet modeli më i mirë që është për komunën tonë.

z.Zenel Maloku, drejtori tha se duhet të shpronësohet, dhe mua po më intereson a mundet Komuna ta shpronësojë atë pjesë pasi që është park nacional.

z.Zenun Shala, në do të bëjmë kërkesë e ta shohim.

z.Leonard Lolluni, ajo pjesë është pronë e Komunës.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes në votim piken e 6 kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se pika e 6 e rendi të ditës u miratua.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për Menagjimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike para anëtarëve të kuvendit e bëri z.Demokrat Ganiqaj, drejtor në DSHPMSI.

z.Leonard Lolluni, kompania që tash menaxhon me mbeturina do të veprojë në baze të kësaj rregullore, apo nënkupton që kjo rregulloren e parasheh vetëm kompaninë që në do ta formojmë si Komune.

z.Ruzhdi Shehu, në bashkëpunim edhe me donatorin e kësaj iniciative GIZ, kemi nisur hartimin e kësaj rregullore që do të jetë në funksione të investimeve të shërbimeve sa më të mira, por edhe të përgjegjësisë që duhet të merren nga organet komunale por edhe nga kompania që menaxhon me mbeturina, kjo i bje që jo vetëm kompania që në do ta formojmë por vjen menjëherë si zbatim i kësaj rregullore pas miratimit.

z.Leonard Lolluni, unë e mora përgjigjen, në faqen 19 pika A të amvisnia po të ishte kjo për kompaninë që të ta formojë komuna do të përkrahi këtë Shumen prej 6.5€ por nuk jam që kompania ambienti të bëjë inkasimin prej 6.5€ për një kontejner, për këtë edhe e shtrova pyetjen me herët.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim piken e 7, kush është për? për 11 vota, kundër 3 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se pika e 7 e rendit te ditës u miratua.

8. Kërkesë nga DSHPMSI për plotësim – ndryshim te një pike ne Rregullore,

Sqarimin dhe arsyetimin e kësaj pike para anëtarëve te kuvendit e beri z.Demokrat Ganiyaj drejtor ne DSHPMSI.

z.Leonard Lolluni, çdo rregullore duhet te ndryshohet me komision, e ne këtë rast është mirë qe te ndryshohet, kuvendi edhe me herët ka provuar te beje qe bizneset te kenë një ditë pushim ne javë, dhe është edhe inspektoriati i punës qe ne bazë te rregullave ja përcakton punëtorëve qe te kenë një dite pushim ne jave.

z.demokrat Ganiyaj, ne kemi kërkesë nga pronaret e bizneseve qe te përcaktohet një dite pushimi ne jave.

z.Sadri Krasniqi, ne po i shohim bizneset se sa janë duke patur punë, shumë pak dhe nëse ja caktojmë një dite pushim mos po i dëmtojmë edhe me shume, normal se te drejtat e punëtorëve duhet te respektohen dhe dihet se kush i mbikëqyrë ato te drejta, dhe me sa jam ne dijeni te gjithë puntoret e kan nga nje dite ne jave pushim.

z.Demokrat Ganiyaj, sot nuk është ka behet qe te votohet kjo rregullore, por vetëm jemi duke e diskutuar neni e 10 pika C te kësaj rregullore.

z.Shpejtim Gacaferi, drejtor te jemi me te qarte se çka është ka kërkohet te ndryshohet.

z.Demokrat Ganiyaj, është ka kërkohet qe sipas rregullores se vjetër pika C thotë qe një ditë pushimi te përcaktohet nga vete biznesi, por nje interpretimi nga juristi thotë se nuk është e përcaktuar se a behet fjale per nje dite pushimi ne jave, ne muaj apo ne vite, dhe ne po kërkojmë qe ta bejme kete ndryshim qe te caktohet një dite ne jave pushim, a ditën e pushimit ne jave e percakton vet biznesi.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e qes ne votim, kush është për ndryshim dhe plotësim te nenit 10 pika C, te jete si ne rregulloren e vjetër por vetëm te shtohet brenda javës, prezent ne sallën e kuvendit janë prezent 13 anëtarët e kuvendit, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se pika e 8 e rendit te ditës u miratua.

9. te Ndryshme.

z.Leonard Lolluni, unë e kam një çështje qe i përket drejtorisë se arsimit, kam informata se shkolla nuk ka patur dru për djege, dhe pasi qe moti filloje te përmirësohet, kam pare se i kane sjellur drutë.

z.Xhavit Velijaj, faleminderit përshëndetje për te gjithë, ne kemi qene ne detyre qe shkollat te mos mbeten pa dru , dhe ne fakt ne kemi bere kërkesë qe te furnizohem me dru me herët, dhe nuk ka qene kohe e gjate qe afërsisht dy ditë qe kanë qenë pa dru.

z.Sadri Krasniqi, unë pata dy pyetje, për njërën morëm përgjigje dhe pyetja tjetër ka te beje me lokacioni e mbeturinave, unë mendoj se është emergjente qe te përcaktohet një lokacion qe te mundemi ti hedhim mbeturinat inerte, çështja tjetër ka te beje me varrezat ne “Rogopeq”, ato nuk janë duke u mirëmbajt, por edhe sistemimi nuk është duke u bere si duhet, largësia e vorrit prej vorrit është 1.5m, dhe nëse shkohet ne këtë mënyrë për 5 vite nuk do te ketë me vend, kërkoj qe ato varreza te mbikëqyrën dhe te bisedohet edhe me imamët qe sistemimi te jete ne mënyrë me te duhur.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për te gjithë, çështja ka te beje me kanalet e ujitjeve, a ka diçka për kete vite a si qëndron puna.

z.Ruzhdi Shehu, po kemi për këtë vit disa ndërtime te kanale te ujitjes por ende nuk ka filluar nga ministria, kemi premtime për 3800m. Dhe do shikojmë se ku është me prioritet edhe do te intervenojme.

z.Leonard Llojuni, desha te ndërlidhem me çështje e varrezave qe e ngriti z.Sadri Krasniqi, unë personalisht kam qene kundër atij lokacionit qe te ketë varreza pra ne “Rogopeq”, atë pjese me e ba varreza mendoj se eshte tmerr për komunën, sepse për deri sa komuna nuk është duke mundur ti liroj hapsirat ku gjinden varrezat ne pjese tjera, me shndërruar një haps ire tjetër komunale ne varreza per mua është tmerr, kështu qe me pas iniciativë qe varrezave te ju ndryshohet lokacioni unë do e kisha përkrahur me shume qefe.

z.Zenel Maloku, unë po ja nisi nga drejtoria e arsimit, me here ne njërën nga mbledhjet e kaluar e kam pyetur drejtorin e arsimit a keni bere furnizimin e duhur me dru, ai është përgjigjur se po, e tash po shohim se edhe këtë vit si vitin e kaluar metra paska qenë me e shkurt, dhe është shume tmerr me këtë nxënësit pa ngrohje një dite dhe siç kemi informata edhe te lëshohen me herët. Qeshtja tjeter ka te beje me ujin e pijes ne lagjen “Agim Ramadani”, keni sjellur dy kroje një nen rruge e tjetrim mbi rruge dhe ati ujit i vije era dhe qytetaret kanë dyshime sepse nuk është i njëjti uje siq e marim ne brendësi ne qendër, andaj kryetar ke premtuar qe uji i pijes do te vije ne lagjen “Agim Ramadani” jo vetem me dy kroje por ne çdo shtëpi, por përkundër kësaj unë propozoi qe gypi qe e sjell ujin nga kanali tek Oda te ndërrohet sepse mendoj se era i vjen ati gypi. Qeshtja tjeter ka te beje me një kërkesë te banorëve te fshatit “Gjocaj”, janë dy shtylla te tensionit te larte qe janë mbetur shum keq kur ka ndodhur rrafshimi i kodrës dhe kam kërkesë nga ta qe komuna te mer masa sa me shpejt për ti vendosur siç duhet ato dy shtylla.

z.Xhavit Velijaj, sa i përket sasisë se druve qe kemi patur këtë vit 2022-2023, unë ju kam informuar edhe me herët dhe e keni atë informatë, dhe nuk ka pasur problem me furnizim me dru perpos asa qe operatori ka vonuar mi sjelle për një dit apo dy.

z.Zenel Maloku. Nuk është kjo arsyetim nxënësit nuk guxojnë që ti lëshojnë mësimin me herët për shkak të mos ngrohjes, kjo është duke na ndodhur që dy vite me radhe dhe unë mendoj se kjo është e pa toleruar që për mos furnizim me dru mësimi të mbahet me ore të shkurtuara, e jo të merren dru si vitin e kaluar në parkun nacional pa letra në prezencë të policisë.

z.Ruzhdi Shehu, po pajtona plotësisht që ka patur mungesë për dy ditë si dhe me atë që planifikimi dhe furnizimi duhet të bëhet me kohe.

z.Demokrat Ganija, sqarim shtesë, drutë nuk janë prerë në zonën e parkut, ura që është dëmtuar në rrugën për Jasiq, ato dru që kanë qenë në urë me pajtim të fshatarëve të “Jasiqit”, kanë qenë edhe policia kemi ra dakort që ato, dru pasi që edhe shkollat kanë mungesë të sjellim në shkollë pasi që shkolla është e të gjithëve.

znj. Rajmonda Krasniqi, përshëndetje për të gjithë, unë pata një çështje që ka të bëjë me permisimin e emrave dhe të mbiemrave të martirëve që janë në përmendoren në qendër, a është marrë ndonjë iniciativë apo si qëndron çështja.

z.Xhavit Velijaj, jemi në proces, është e planifikuar edhe nga prokurimi edhe nga financimi dhe jemi në proces të ndërrimit të asaj pllake dhe e kemi të paraparë që në Prill të viti 2023 të ndërhyhet.

z.Demokrat Ganija, sa i përket kërkesës së banorëve të fshatit “Gjocaj” për ato dy shtylla të tensionit të lartë, ato dy shtylla janë në pronën private dhe se është bërë kërkesa që ato të barten afër rrugës.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen e Marsit 2023

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi
